



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 .dhjetor 2011
Nr. ref.: RK166/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 91/11

parashtruesi

Xhevrije Haliti

**Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës Rev.nr.588/2008 i datës 14.4.2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është znj. Xhevrije Haliti nga Ferizaj me banim në rr. "Astrit Bytyqi" nr. 65, të cilën e përfaqëson me autorizim, avokati z. Halil Ilazi nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.588/2008 i datës 14.4.2011 të cilin parashtruesja e kërkesës sipas pohimit personal e ka pranuar me 2.6.2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 4 korrik 2011 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.588/2008 të 14 prillit 2011 me të cilin Gjykata Supreme e kishte pranuar Revizionin e të paditurës "Raiffeisen Bank" në të cilën parashtruesja e kërkesës kishte punuar prej vitit 2002 e më pastaj në tetor të vitit 2003 i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese

4. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 49 (e drejta e punës dhe zgjedhja e profesionit), neni 31 (e drejta në Gjykim të drejtë dhe të paanshëm), neni 54 (e drejta në mbrojtje gjyqësore e të drejtave).

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

Ankesa e parashtruesit

6. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev.nr 588/2008 të datës 14.4.2011 ia ka mohuar të drejtën për punë të cilën përndryshe Gjykata Komunale në Ferizaj me aktgjykimin C. Nr 470 /03.04.2007 dhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin AC. Nr 497/07, të datës 14.10.2008 ia kishin njohur.

Procedura në Gjykatë

7. Më 4 korrik.2011 Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e znj. Xhevrije Halitit të cilën në Gjykatë në emër të saj me autorizim e paraqiti, avokati z. Mr. Halil Ilazi dhe e regjistroi atë me nr KI 91/11
8. Më 17 gusht 2011 me vendimin GJR 91/11 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtarin Robert Carolan
9. Të njëjtën ditë Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Altay Suroy (kryesues) dhe gjyqtarët Ivan Čukalović dhe dr. Gjylijeta Mushkolaj në cilësi të anëtarëve të kolegjit
10. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës dhe përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës më 5 gusht 2011 , për regjistrimin e lëndës por në afatin ligjor nuk ishte marrë asnjë koment nga asnjëra palë.

11. Me 30 nëntor 2011 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 1 tetor 2003 znj. Xhevrije ka marrë njoftimin me shkrim nga "Raiffeisen bank" se nga data 1 tetor 2003, asaj ,bazuar në nenin 1 të Kontratës së saj të punës, saj do t'i përfundojë punësimi në këtë bankë, ndërsa përfundimi i punësimit bëhet për shkaqe të riorganizimit dhe numrit të tepërt të punëtorëve në degën e kësaj banke në Ferizaj.
13. Më 3.4.2007 Gjykata komunale në Ferizaj ka nxjerrë Aktgjykimin Ac.nr.470/03 me anë të cilit ka Aprovuar padinë e paditëses znj. Xhevrije Haliti, dhe ka anuluar vendimin për shkëputjen e njëanshme të kontratës së punës dhe njëkohësisht ka obliguar të paditurën "Raiffeisen bank" që paditëses t`i kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 708.00 €.
14. Më 14.10.20078 Gjykata e Qarkut në Prishtinë duke vepruar sipas ankesës së "Raiffeisen bank" ka nxjerrë Aktgjykimin Ac.nr.497/2007 me anë të cilit ka refuzuar ankesën e të paditurës "Raiffeisen bank" dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Ferizajt C.nr 470/03 të datës 3. 4.2007.
15. Sipas pohimit të përfaqësuesit të znj. Haliti avokatit z. Halil Ilazi pas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.497/2007 "Raiffeisen bank" kishte kthyer në punë znj. Xhevrije Haliti dhe ajo vazhdon të punojë në këtë institucion që nga 1 nëntori 2011.
16. Më 14.04.2011 Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas Revizionit të paditurës "Raiffeisen bank" ka nxjerrë Aktgjykimin Rev.nr. 588 /2008 me anë të cilit ka pranuar Revizionin e të paditurës dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr 497/2007 të datës 14.10.2008 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Ferizaj C.nr 470/2003 të datës 3.4.2007 ashtu që KA REFUZUAR kërkesëpadinë e paditëses Xhevrije Haliti për anulimin e shkëputjes së kontratës së punës së saj dhe kthimin në vendin e punës në "Raiffeisen bank" - dega në Ferizaj.
17. Gjykata Supreme në pjesën arsyetuese të Aktgjykim it të sajë Rev. nr. 588/2008 ka konkluduar se Gjykata e instancave më të ulta në këtë rast kanë bërë vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike por kanë aplikuar gabimisht të dispozitat materiale . Prandaj Gjykata Supreme ka nxjerrë përfundimin se kualifikimi ligjor i Gjykatave të më të ulta se ndërprerja e kontratës së punës për parashtruesen kërkesës është bërë duke shkelur nenin 11.1 të rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës,,**është i papranueshëm** sepse neni 11.4 (b) i të njëjtit ligj parasheh se gabimet e përsëritura të punëtorit janë bazë e mjaftueshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e që sipas Gjykatës Supreme kishte ndodhur në rastin konkret, dhe në përputhje me këtë kualifikim ligjor të fakteve edhe ka anuluar Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulta.
18. Më 6 qershor 2011, pra 4 ditë pasi që kishte pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme e cila kishte vendosur lidhur me Revizionin e paraqitur nga "Raiffeisen bank" lidhur me kontestin e punës që ka të bëjë me te, znj. Xhevrije Haliti kishte nënshkruar kontratë të re pune për një afat kohor të pacaktuar, por që kushtëzohet me performancën e punës

së të punësuarës dhe mund të jetë objekt i shkëputjes sipas kushteve të cekura në nenin 8 të sajë.

19. Përfundimisht përkundër faktit se kishte një kontratë të re pune me të njëjtin punëdhënës znj, Xhevrije Haliti, nëpërmes avokatit z. Halil Ilazi më 4.7.2011 paraqiti kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Revizionit të Gjykatës Supreme rev. Rev.nr. 588 /2008 të datës 14.4.2011.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për Kërkesën e Parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.
21. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.**"*

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar:

22. Duke iu referuar shkeljes së supozuar të së drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të Konventave e instrumenteve të tjera Ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vëren:
23. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] pika 3. të Kushtetutës është qartazi e paraparë: që "Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit."
24. Në nenin **103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]**, të Kushtetutës në pikën 2 është gjithashtu qartazi e përcaktuar se: "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor."
25. Në këtë drejtim Gjykata Kushtetuese nuk gjen asnjë fakt se Gjykata Supreme duke Vendosur sipas Kërkesës për Revizion për të cilën shprehimisht është e autorizuar në bazë të nenit 212 të LPK-së të ketë shkelur nenin 31.2 (e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm) nenin 54 (mbrojtja gjyqësore e të drejtave) apo nenin 6 i KEDNJ (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) për të cilat parashtruesi i kërkesës ka supozuar se janë shkelur.
26. Në fakt parashtruesi i kërkesës përpos shprehjes së mos kënaqësisë për Revizionin e nxjerrë nga Gjykata Supreme nuk ka argumentuar në mënyrë bindëse se pse gjykimi "nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm" se në cilën mënyrë ai ka qenë i trajtuar si i pabarabartë apo cila fazë e procedurës ka qenë kundër kushtetuese.
27. Fakti se parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese vazhdon të punojë në "Raiffeisen bank" dhe se ka lidhur një kontratë të re pune nuk është qenësor për këtë çështje juridike dhe nuk argumenton shkeljet eventuale Kushtetuese në Aktgjykimin e sfiduar, pasi që ai si i tillë ka ndodhur pasi që Gjykata Supreme të ketë vendosur lidhur

me Revizionin dhe nuk ishte pjesë e provave të paraqitura para asaj Gjykate. Për më tepër përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës edhe vetë në kërkesë ka theksuar se kontrata e re e punës e lidhur ne mes të parashtrues së kërkesës dhe punëdhënësit të saj pasi që Gjykata Supreme kishte vendosur lidhur me Revizionin e të paditurës, është fakt i ri i cili nuk ndikon drejtpërsëdrejti në këtë çështje juridike, por megjithatë sipas tij nuk është në kundërshtim me të drejtën.

28. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta dhe se roli i saj (i GJ. Kushtuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kunder Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65.
29. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
30. Në këto rrethana Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka "Gjykuar drejt dhe paanshëm" duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të jenë shkelur të drejtat e garantuara me kushtetutë.
31. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" andaj, i propozoj kolegjit shqyrtues që në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d ta refuzojë kërkesën si qartas të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE


Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 30 nëntor, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani